



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T

i mbledhjes së katërt të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18.4.2025, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Adnan Ajeti dhe, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh, Elmira Nikçi – Rexha dhe Triera Kasumi – Berisha.

Mungoi: Faton Marolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Ekzon Pacolli, shef i personelit, Klaudia Mula, zyrtare nga ZKKK, Premitme Preniqi, kordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore dhe Qefsere Veseli, zyrtare në Zyrën për komunitete dhe kthim.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Mirsada Behluli, kryesuese e komitetit me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit e Komitetit për Komunitete;
2. Ftesë për kryetarin e Kuvendit në një takim pune nga KK, lidhur me koordinimin të punës dhe informacionit rreth nevojave dhe problemeve të komunitetit joshumicë;
3. Takim me shefin e personelit, biseda në lidhje me respektimin e të drejtave të komunitetit joshumicë në punësim dhe përfaqësim;
4. Ftesë zyrtares për barazi gjinore, raporti mbi sfidat dhe projektet në vitin 2024/25;
5. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit;
6. Raporti i ZKKK-ës, për muajin mars 2025;
7. Raporti i përfaqësuesve të komunitetit joshumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
8. Të ndryshme.

## Pika e parë

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete.**

**Mirsada Behluli**, kryesuese bëri vërejtje në pikën e katërt të rendit të ditës e cila tha se duhet të jet: Qytetarët e lagjes “Kalabria”, kryesisht banorët afër rrugës “Sylejman Vuçitërna” kan kërkuar që të rritet numri i lokacioneve me kontejnerë. Po ashtu vërejtje në pikën e gjashtë që ka të bëjë me raportin e ZKKK-së, me ç’rast tha se, duhet të jet: Të përkrahët transporti për 80 nxënës të komunitetit turk që udhëtojnë më shumë se 5 kilometra për me ardhur në shkollë në gjuhën turke në Prishtinë, si dhe duhet të jet që: Z. Nenad Milladinoviq, përfaqësues i komunitetit serb ka paraqitur një problem që ka ndodhur në Bërnicë.

**Triera Kasumi**, i njoftoi të pranishmit lidhur me transportin e nxënësve e cila tha se, Kuvendi Komunal e ka votua propozimin për subvencionimin e transportit të nxënësve të cilët udhëtojnë më shumë se 2 kilometra, kështu që në këtë subvencionim përfshihen të gjithë nxënësit e komuniteteve.

**Me vërejtet e dhëna, kryesuesja konstatoi se, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete.**

## Pika e dytë

**Ftesë e kryesuesit të Kuvendit për mbledhjen e KK-së lidhur me koordinimin të punës me ZKKK-në, duke informuar për nevojat dhe problemet e komuniteti joshumicë.**

Në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, kryesuesja e komitetit tha se kjo pikë shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës së komitetit.

## Pika e tretë

**Takim me shefin e personelit, biseda në lidhje me respektimin e të drejtave të komunitetit joshumicë në punësim dhe përfaqësim.**

**Egson Pacolli**, në pikë të shkurtra i informoi anëtarët e komitetit lidhur me punësimin në Komunën e Prishtinës, duke shtuar se, sipas shënimive dhe informatave që ka Zyra e personelit, në 3 vitet e fundit, komunitetet jo-shumicë nuk u janë përgjigjur konkurseve, kështu në vitin 2023 u mor vendimi për të shpallur një konkurs të veçantë për pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara, me qëllim kapërcimin e këtij problemi. Ai gjithashtu tha se, gjatë vitit 2024, 2 kandidatë nga komuniteti turk u punësuan, njëri në shkollën “Elena Gjika” dhe tjetri në shkollën “Sami Frashëri”, ndërsa një ashkali punon në administratë, si dhe po ashtu 14 anëtarë të komuniteteve pakicë punojnë në shërbimet publike në Komunën e Prishtinës.

**Okty Kurtesh** deklaroi se, nuk ka punonjës nga komuniteti turk, ku në Komunë punon vetëm një përfaqësuese e kominitetit turk, si dhe ngriti përsëri problemin e përdorimit të gjuhës turke në Komunën e Prishtinës, duke përmendur shembullin e Komunës së Gjilanit dhe të Mitrovicës.

**Egzon Pacolli** deklaroi se ne kemi punësuar ashkali dhe romë nga komunitete të tjera, por për shkak të nivelit të tyre të arsimimit, ata nuk kanë mundur të gjejnë punë, sepse duhet të aplikojnë përmes një aplikimi online. Ne po shqyrtojmë punë për persona me aftësi të kufizuara, siç janë punët si nëpunës dhe teknik. Në Komunën e Prishtinës janë të punësuar 520 punëtorë. Duhet theksuar gjithashu se është shpall një mini-konkurs për mësues në gjuhën boshnjake dhe për 2 mësues në gjuhën turke.

Duke pasur parasysh diskutimet në lidhje me respektimin e të drejtave të komunitetit joshumicë në punësim dhe përfaqësim, anëtarët e Komitetit kërkuan që Komuna e Prishtinës të respektojë përqindjen e përfaqësimit 100% sipas Ligjit të Punësimit. 1

**Nenad Miladinoviq** tha se, prej 520 punëtorëve të punësuar në Komunën e Prishtinës, 10% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve janë nga komunitetet joshumicë dhe sipas deklarimit të shefit të Personelit, se ky është një numër i madh dhe se përfaqësimi aktual është 3-5% për komunitetet pakicë.

**Oktay Kurtesh** kërkoi që të jetë një përkthyes në gjuhën turke, si dhe gjuha turke të jet gjuhë në përdorim dhe në tabelën e Komunës të shkruhet emërtimi i këtij institucione edhe në gjuhën turke, ku si shembull mori shkollat "Sami Frashëri" dhe "Elena Gjika". Sa i përket Komunës së Prishtines, sipas regjistrimit të vitit 2024, ajo ka numrin më të madh të anëtarëve të komunitetit turk, gjithsej 2,156.

**Egzon Pacolli** tha se kjo mvaret nga përqindja e popullsisë në një komunë.

**Ermira Nikçi**, nuk u pajtua me deklarimin e përfaqësuesit të komunitetit turk e cila tha se, komuniteti turk duhet t'i deklarojë problemet e komunitetit të saj me shkrim dhe jo në mënyrë verbale në mbledhjet e komitetit. Lidhur me futjen në përdorim të gjuhës turke, ajo tha se nuk është e mundur të zgjidhet asnjë problem pa një kërkesë.

**Nenad Miladinoviq**, kërkoi të dijë se si mund të punësohen punëtorët në Komunën e Prishtines, qoftë përmes kontratave të punës, testimit, dhe cila është arsyaja e reagimit të ulët nga komunitetet për të punësuar të rinj nga komunitetet joshumicë, sepse ata kanë humbur besimin se shpesh kur kanë aplikuar nuk janë punësuar.

**Egzon Pacolli** tha se kontrata për punë nuk lejohet më dhe e vetmja mënyrë që komunitetet joshumicë të punësohen është përmes një konkursi, përmes një projekti. Një problem tjetër është mungesa e njohurive të gjuhës.

**Nenad Miladinoviq** propozoi që në sportelet e Komunës së Prishtinës, për të lehtësuar aksesin për klientët për shkak të mungesës së aftësive gjuhësore, të ketë nga një person me njohuri të të dy gjuhëve në secilin seksion, për të ndihmuar klientët që nuk e dinë gjuhën tjetër.

## Pika e katërt

Ftesë zyrtares për barazi gjinore, raporti mbi sfidat dhe projektet në vitin 2024/25.

**Premtime Preniqi** tha se, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare që lidhen me dhunën në familje është përfshirë policia, drejtoria përkatëse e Komunës së Prishtines për nevojat e viktimate të dhunës në familje po punon për edukimin, për ndërgjegjësimin e kontrollit të trafikut, në bashkëpunim me organizatën “Gratë për të drejtën e grave” për të ushtruar të drejtat e tyre në pronë, ku janë më se 24 qendra për kujdesin e viktimate të dhunës. Aktualisht në to janë të akomoduar anëtarë të komuniteteve joshumicë, ku prej tyre janë 4 turq, 1 boshnjak, 8 ashkali dhe 1 i huaj. Të gjitha komunitetet janë të përfshira në kujdesin ditor, ku bëhet punë për kujdesin ndaj viktimate përmes aktiviteteve të ndryshme. Një numër shumë i vogël pjesëmarrësish në debate bënë thirrje për të njohur të gjitha llojet e dhunës dhe për të organizuar aktivitete për barazinë gjinore.

**Klaudia Mula** kërkoi të dijë se, kur ndodh dhunë në familje, si zgjidhet ajo.

**Premtime Preniqi** tha se, së pari ata regjistrohen në SHPK, dhe nëse çifti ka fëmijë, thirret Qendra e Mirëqenies Sociale, merret një deklaratë, por nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme për kujdes ditor, ata vendosen në një shtëpi të sigurt. Dhuna është një vepër penale dhe trajtohet njësoj si vrasja. Kjo është arsyesa pse organizohen leksione dhe debate me ekspertë të të gjitha kategorive.

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se duke pasur parasysh diskutimin e znj. Preniqi, ne patjetër duhet të punojmë në parandalim, të identifikojmë se ku janë problemet dhe të ndihmojmë për të shmhanguj një rezultat tragjik me të cilin u përballëm në Kosovë dhe më gjërë.

#### **Pika e pestë**

##### **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit;**

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, kjo pikë shtyhet për diskutim në njëren nga mbledhjet e radhës së komitetit.

#### **Pika e gjashtë**

##### **Raporti i ZKKK-së për muajin mars 2025.**

Lidhur me raportin e ZKKK-së, anëtarët e komitetit në pika të shkurtra i informoi Misada Behluli, kryesuese.

## Pika e shtatë

### Raporti i përfaqësuesve të komunitetit joshumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se, sa i përket çështjes së sigurisë në komunitet, nuk kishte ndonjë problem që vlenë të theksohet, përveç problemit të ndriçimit në disa zona dhe vendbanime të caktuara dhe se ky problem nuk mund të zgjidhet për momentin, sepse nuk ka kontratë të nënshkruar për ndriçim. Ajo gjithashtu theksoi se, u arrit në përfundimin se çdo kërkesë nga një komunitet joshumicë duhet të dorëzohet me shkrim dhe të nënshkruhet në sportelin komunal, në mënyrë që të mund të përcillet zyrtarisht nga ZKKK-ja te drejtore përkatëse.

Takimi i radhës do të mbahet më dt. 15.5.2025.

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesja e komitetit  
Mirsada Behluli



Faqe 5 nga 5